



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. 2026

Lënda: Mbi trajtimin e kërkesave për informim

Z. M. K.

MCN TV

**Adresa: Rruga e Vilave, Lundër
Tiranë**

Në përgjigje të kërkesave tuaja për informim, protokolluar në Departamentin e Administratës Publike me nr. 3903, datë 09.07.2026, nr. 3904, datë 09.07.2026 dhe nr. 3905, datë 09.07.2026, nëpërmjet të cilave kërkon informacion mbi operatorët ekonomikë që janë shpallur fitues pranë Departamenti të Administratës Publike (DAP), lidhur me shërbimin e pastrimit gjatë viteve 2013-2026, si dhe të dhëna të ndryshme lidhur me marrëdhënien e punësimit pranë institucionit tonë për z. Xh. Gj. dhe z. E. Gj., ju sqarojmë sa vijon:

Për secilën prej kërkesave janë paraqitur të dhënat përkatëse, të mbështetura në dokumentacionin e administruar dhe në të dhënat e evidentuara në regjistrat zyrtarë. Informacioni i paraqitur është përgatitur mbi bazën e të dhënave dhe dokumentacionit të administruar nga Protokoll-Arkiva, si dhe dokumentacionit të dosjes së personelit të administruar nga Departamenti i Administratës Publike.

Më poshtë paraqiten tabelat e strukturuar sipas kërkesave tuaja:

1. Lista e operatorëve ekonomik të shpallur fitues për shërbimin e pastrimit gjatë periudhës 2014 – 2026

Viti	Operatori Ekonomik	NIPT	Referenca procedures prokurimit	Nr./Data e Kontratës	Afati i Kontratës	Vlera (pa TVSH) lekë
2014	Majlind Lamçe	K81517019P	DAP	Nr. 1500, datë 02.06.2014	7 muaj, duke filluar nga 01.06.2014	145,000
2015	Pastrime Silvio	K91413010N	DAP	Nr. 670, datë 19.02.2015	01.03.2015 – 31.12.2015 (10 muaj)	365,000

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

2016	Pastrime Silvio	K91413010N	DAP	Nr. 6684, datë 31.12.2015	Nga 01.01.2016 deri me 31.12.2016	595,000
2017	Pastrime Silvio	K91413010N	DAP	Nr. 6684/1, datë 05.01.2017	Sipas kontratës	620,000
2018	Shpresa sh.p.k.	K67917301H	DAP	Nr. 5584/1, datë 24.07.2018	115 ditë	402,521
2018 (shtesë kontrate)	Shpresa sh.p.k.	K67917301H	DAP	Nr. 9138, datë 21.12.2018	01.01.2019 — 06.02.2019	96,605
2019	Pastrime Silvio	K91413010N	OBP	Nr. 1501, datë 07.03.2019	07.03.2019 — 06.03.2021	1,698,523
2021	CLEAN FAST	L6180703R	OBP	Nr. 2537, datë 16.04.2021	2 vjet	2,498,754
2025	ALPEN PULITO	K61516506H	OBB	Nr. 6794/1, datë 23.01.2025	24 muaj	5,678,040

2. Të dhënat e kërkuara për z. E. Gj.

Nr.	Kërkesa	Informacioni/Përgjigja
1	Cilin pozicion mbulonte E.Gj. në janar 2026?	Z. Gj. nuk ka qenë staf i DAP-it në janar 2026. Ai ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me DAP-in në datë 9.2.2024.
2	A u shkarkua pas masës së arrestit z. Gj.?	Z. Gj. nuk ka qenë staf i DAP-it në janar 2026.
3	Kur ka filluar punësimin pranë DAP dhe cilat pozicione ka mbajtur?	Punësimi i z. Gj. në DAP ka filluar në datën 15.12.2015 dhe deri në datën 9.2.2024, kur ka ndërprerë marrëdhënien financiare me institucionin, ka mbajtur pozicionet si vijon: a) Specialist në Sektorin e Planifikimit dhe Sekretariatit Teknik, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit të Administratës Publike. b) Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Administratës Publike, në Drejtorinë e Programeve të Reformës në Administratën Publike.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

		c) Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Modernizimit në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Programeve të Reformës në Administratën Publike.
4	Kopje të listëprezencave	Bashkëlidhur gjeni kopje të listëprezencave që kemi në administrim.
5	Sa mungesa ka kryer?	Nga verifikimi i listëprezencave rezulton se nuk ka mungesa.
6	Sa ditë leje ka kërkuar?	Nga verifikimi i listëprezencave rezulton se numri i përgjithshëm i ditëve të lejeve është 42.
7	Në sa grupe pune ka marrë pjesë?	Nga dokumentacioni që disponojmë rezulton se nuk ka marrë pjesë në grupe pune.
8	Numri i akteve/dokumente të hartuara.	Natyra e punës e kryer nga z. Gj. nuk lidhet me hartim shkresash/dokumentash, por me menaxhimin dhe përdorimin e sistemeve elektronike.
9	Në sa komisione ka marrë pjesë?	Nga dokumentacioni që disponojmë rezulton se nuk ka marrë pjesë në komisione.

3. Të dhënat e kërkuara për z. Xh. Gj.

Nr.	Kërkesa	Informacioni/Përgjigja
1	Cilin pozicion mbulonte z. Xh. Gj. në janar 2026?	Pozicioni i z. Gj. në janar 2026 ka qenë specialist në Sektorin e Programeve të Modernizimit në Fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Programeve të Reformës në Administratën Publike.
2	Kur ka filluar punësimin pranë DAP dhe cilat pozicione ka mbajtur?	Z. Gj. ka filluar punë në DAP në datën 07.09.2016 dhe ka mbajtur pozicionet si vijon: a) Specialist në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit. b) Specialist në Sektorin e Programeve të Modernizimit në Fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Programeve të Reformës në Administratën Publike. c) Për periudhën 19.3.2025 – 21.5.2025, z. Gj. nuk ka qenë në marrëdhënie punësimi me DAP për shkak të pezullimit. d) Nga data 22.5.2025, z. Gj. është rikthyer nga pezullimi në të njëjtin pozicion që ka mbajtur përpara pezullimit.
3	Kopje të listëprezencave	Bashkëlidhur gjeni kopje të listëprezencave që kemi në administrim.
4	Sa mungesa ka kryer?	Nga verifikimi i listëprezencave rezulton se nuk ka mungesa.
5	Sa dite leje ka kërkuar	Nga verifikimi i listëprezencave rezulton se numri i përgjithshëm i ditëve të lejeve është 51.
6	Në sa grupe pune ka marrë pjesë?	Nga dokumentacioni që disponojmë rezulton se nuk ka marrë pjesë në grupe pune.
7	Numri i akteve/dokumente të hartuara	Natyra e punës e kryer nga z. Gj. nuk lidhet me hartim shkresash/dokumentash, por me menaxhimin dhe përdorimin e sistemeve elektronike.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATES PUBLIKE

8	Në sa komisione ka marrë pjesë?	Nga dokumentacioni që disponojmë rezulton se z. Gj. ka qenë anëtar i KVO-së në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim i ruajtjes së objektit me roje private”.
---	---------------------------------	--

Si përfundim, sqarojmë se, kërkesat tuaja për informim janë regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2026 të DAP-it, respektivisht me numrat rendorë 16, 17 dhe 18 sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.